



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 7

Kryendrituri mbledh 'Kuvendin kombëtar qytetar' për të 'drejtuar vendin' pas protestave! Vetëm shen dhe skuzi mes pjesëmarrësve, dhe ende të paqarta si bie Rama (VIDEO)
- 2

Më të paktë në numër, qytetarët në protestë për të 49-ën ditë! Organizatorët kundër mbledhjes së 'Kuvendit Qytetar': Përfaqësuesit janë në shesh
- 3

Moderatorja e njohur shtatzenë për herë të tretë? (FOTO)
- 4

Spanja më shqetëson sapo del me autobus nga hoteli', Scaloni: Messi është futbollisti më i madh që ka parë bota
- 5

I vë flakën pyllit dhe largohet si të mos kishte ndodhur asgjë, arrestohet 50-vjeçari shqiptar në Greqi! Dalin pamjet nga momenti i zjarrit (VIDEO)


Kronikë

Atentati në Sarandë/ 9 plumba drejt Thimjo Rubatit, autorët me skafandra ikën me skaf! Gjendet motori që përdorën! 50-vjeçari: S'i njoha

Detaje të reja dalin në dritë një ditë pas atentatit ndaj biznesmenit 50-vjeçar Thimjo Rubati, i cili mbeti i plagosur mbërmjen e së premtes në Sarandë. Sipas hetimeve paraprake, dy autorët me skafandra që lëviznin me motor e kanë qëlluar me 9 plumba pistolete dhe janë larguar me skaf.

■ Dhunimi i oficerit të policisë në Sarandë, 3 në kërkim! Mes tyre edhe djali i Thimjo Rubatit që iu bë atentat

Atentati në Sarandë/ 9 plumba drejt Thimjo Rubatit, autorët me skafand



Limos Didani 18 Korrik, 09:24 | Përditësimi: 18 Korrik, 18:05



Thimjo Rubati, 50-vjec **u qëllua me 9 plumba** pistolete, mbërmjen e së premtes teksa qëndronte në ambientet e jashtme të biznesit të tij, një parkim për automjete në lagjen nr 4 të Sarandës. Burime për Report Tv thanë se dy autorët me motor dhe skafandra kanë ardhur nga rruga "Mit'hat Hoxha", në drejtim nga stadiumi për te porti. Sapo kanë konstatuar Rubatin pranë biznesit të tij, kanë hapur zjarr me një pistoletë të kalibrit 9 milimetra, duke qëlluar 9 herë. Nga të shtënat, 50-vjeçari ka marrë 3 plumba.

Rubati, i cili ka qenë i vetëdijshëm pas sulmit, u ka deklaruar hetuesve se nuk ka mundur të identifikojë autorët. Fillimisht ai u dërgua në spitalin e Sarandës dhe më pas u transportua drejt Janinës, ku mësohet se është jashtë rrezikut për jetën.

Pas atentatit, autorët janë larguar në të njëjtin itinerar drejt zonës së njohur si Baba Rexhepit. Hetuesit dyshojnë se më pas ata janë larguar me skaf. Në të njëjtën zonë, u gjet edhe një motor i braktisur, që dyshohet se u përket autorëve.

Shënjestra e atentatit, Thimjo Rubati, i njohur edhe si Sandri Rubati, është një emër i njohur për drejtësinë shqiptare dhe greke. Aktiviteti i tij kriminal daton prej më shumë se dy dekadash. Në vitin 2002 është arrestuar dhe dënuar në Shqipëri për trafikim të të miturve dhe përdhunim, ndërsa në vitin 2012 u arrestua sërish, i akuzuar për rrëmbimin e një vajze 16-vjeçare. Rubati rezultoi gjithashtu i proceduar për armëmbajtje pa leje, kontrabandë, trafikim të emigrantëve të paligjshëm dhe trafikim të mjeteve motorike.


Teksa vuante dënimin në Greqi, në vendin tone kërkohej për kontrabandë automjete, ku ishin të përfshirë edhe doganieri. Pas përfundimit të dënimit në Greqi, Rubati u përball me drejtësinë shqiptare për dosjen e kontrabandës por Gjykata e Apelit e dënoi me kusht, duke pezulluar vuajtjen e dënimit me burg.

Pista e hetimit, thane burimet lidhet me të shkuarën kriminale të tij brenda e jashtë vendit, por nuk përjashtohet as ndonjë konflikt që mund të ketë krijuar kohë e fundit, por deri më tani nuk janë identifikuar autorët.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 17:10

Atentati ndaj Thimjo Rubatit/ Gjendet një motor i braktisur buzë detit në Sarandë, dyshohet i autorëve



Policia e Sarandës pas kontrolleve në lagjen "Baba Rexhepi", zonë kjo ku u drejtuan autorët pas atentatit ndaj 50-vjeçarit Thimjo Rubati, kanë gjetur një motorr të braktisur.

Motorri u gjet buzë detit, në një prej gjireve detare të zonës, pikërisht në zonën e quajtur "Kasollja". Policia dyshon se motorri i përket autorëve të atentatit të mbërmjes të së premtes.

Sl.E./Shqiptarja.com

Xh.K/E.H/Shqiptarja.com

TAG: Vlore sarande atentat thimjo rubati

Komento

Popull: 18/07/2026 15:57
Smth gazetaret skan problem qe ky plehera rremben minoren dhe i shet, eshte thjesht nje detaj i vogel. Mos e nxirni nga spitali i vini nie jastek siper dhe mos ta shofi me driten e diellit.

Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH ZON

Sondazhi i ditës: 18 Korrik, 19:55

Finalja Spanjë-Argjentinë, kush e fiton Kupën e Botës?

Spanja Argentina Nuk kam mendim

Lajme të tjera

Zhupa: Bashkia e Sarandës 1 mln euro abuzim me fondet në 1 vit, i çojmë dosjen drejtësisë 18 Korrik, 12:52

U shpëtuan nga mbytja afër Sazanit, largimi me gomone i 11 emigrantëve u organizua nga një afgan! 43-vjeçari i huaj i futi nga Greqia me një shqiptar (VIDEO) 18 Korrik, 12:23

Dhunimi i oficerit të policisë në Sarandë, shpallen në kërkim tre persona! Mes tyre edhe djali i Thimjo Rubatit që iu bë atentat 18 Korrik, 10:28

Atentat në Sarandë, nën shënjestër Thimjo Rubati, e qëlluan dy persona të maskuar! I plagosuri me dy identitete e precedent kriminal (VIDEO) 17 Korrik, 21:48

Punimet për shëtitoren e re të Ksamilit, Rama: Një tjetër hapësirë publike për çdo vizitor që zgjedh këtë perlë të Shqipërisë (VIDEO) 17 Korrik, 16:27

Gomonia me 11 emigrantë të paligjshëm rrezikoi mbytjen, Policia: Nga monitorimet me dron nuk është konstatuar asnjë tentativë për të lëvizur drejt ujërave ndërkombëtare (VIDEO) 17 Korrik, 15:33

Vlorë/ Zjarr në zonën e Mifolit, digjet sipërfaqja me shkurre e ullinj! Zjarrfikësit në vendngjarje 17 Korrik, 14:43

Dështon 'arratisja' e 11 emigrantëve nga Vlorë drejt Italisë, gomonia pëson avari 8 milje larg grykëderdhjes së Vjosës! Policia në kërkim të trafikantëve (Video) 16 Korrik, 13:40

Sarandë/ Oficeri i Policisë përfshihet në sherr me disa persona, 'Blutë' kontrolle të shumta në qytet! Disa të shoqëruar (EMRI) 17 Korrik, 09:26

Himara, një nga destinacionet e preferuara turistike në vend! Numër i lartë kërkesash për akomodim (VIDEO) 16 Korrik, 22:30

Ndotje mjedisore në Dhërmë nga përpunimi i inerteve të gurit, IKMT pezullon dhe gjobit 5 kompani (FOTO) 16 Korrik, 13:40

Do i shiste 4 pistoleta grupit kriminal në Sarandë, arrestohet i ri! Momenti kur policia e ndjek nga pas dhe e rrethon në tunelin e Skërficës (VIDEO) 16 Korrik, 10:04

Më të paktë në numër, qytetarët në protestë për të 49-ën ditë! Organizatorët kundër mbledhjes së 'Kuvendit Qytetar': Përfaqësuesit janë në shesh 18 Korrik, 20:25

Kodi Etik Kontakt Rreth Nesh Raportoni Ju Pu

[Shqiptarja.com]

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

GetButton



Më të paktë në numër, qytetarët në protestë për të 49-ën ditë!
Organizatorët kundër mbledhjes së 'Kuvendit Qytetar':
Përfaqësuesit janë në shesh

18 Korrik, 20:25

